



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		03/06/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/04-	20336	



Data/Date: 26/05/2025

Nga/Od/From: Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2026-2028

Për/Za/To: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

Tema/Subjekat/Subject: Procesverbali i takimit të parë konsultativ publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2026--2028

**Procesverbali i Takimit të Parë Konsultativ Publik
për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028**

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet Buxhetore 2025-2027, sipas vendimit të kryetarit nr. 01-400/01-8037, i datës: 27/02/2025, dhe ftesës për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2026-2028, nr. 01-060/03-18323, i datës 19/05/2025, linqet në ueb-faqe të komunës: <https://gllogoc.rks-gov.net/news/f-t-e-s-e-21/>; si dhe linku në Facebook: [https://www.facebook.com/komunadrenas?_cft__\[0\]=AZViW9_JDNX4RRfFmDKSqSyWD8ngQZsCBbkuwLqjEluMuW7URI-SKyNJRNXgNduq4beLZPVzhNyf8_OA0FCtwKEeOmFSTFgfmjbxJBqA10VX_EGpAR8VqP8LT2LGlrRfthoTs-e7KoTPVaSBXP6NtzCVKNVhtOOob9Ip7_qQFMNXmZT4Uls3gOULs0yvJNqjxrfmm-fV6WhzA7X8N5CI8YQCl&_tn_=-UC%2CP-R](https://www.facebook.com/komunadrenas?_cft__[0]=AZViW9_JDNX4RRfFmDKSqSyWD8ngQZsCBbkuwLqjEluMuW7URI-SKyNJRNXgNduq4beLZPVzhNyf8_OA0FCtwKEeOmFSTFgfmjbxJBqA10VX_EGpAR8VqP8LT2LGlrRfthoTs-e7KoTPVaSBXP6NtzCVKNVhtOOob9Ip7_qQFMNXmZT4Uls3gOULs0yvJNqjxrfmm-fV6WhzA7X8N5CI8YQCl&_tn_=-UC%2CP-R) u mbajt takimi i parë publik.



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	19/05/2025		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/03	18323	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 19.05.2025

F t e s ë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën 19.05.2025, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të pranuar komentet, sugjerimet, propozimet dhe kërkesat hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2026-2028 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

Komentet, kërkesat, propozimet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 30.05.2025 në orën 16:00, në e-mail-at e zyrtarëve: albulena.saliuku@rks-gov.net; bekim.dobra@rks-gov.net avdyli.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
<https://gllogoc.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/>

Platformën për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:


Dëgjimet publike për KAB 2024	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, etj).	26.05.2025	Salla e Kuvendit	10:30
Dëgjimi i dytë publik me grupe të interesit (biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	26.05.2025	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!



Bekim Dobra

Udhëheqës i Zyres për Komunikim me Publikun



1. Hapja e Takimit Konsultativ

Më 26 maj 2025, në ora 10:30, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit, është mbajtur takimi i parë publik për dëgjim lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2026–2028. Ky takim u organizua në kuadër të përpjekjeve për të përfshirë qytetarët dhe akterët relevantë në procesin e planifikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike buxhetore.

Takimi u udhëhoq nga zyrtari për informim i Komunës së Drenasit, **z. Bekim Dobra**. Në këtë takim morën pjesë Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar, drejtorët e drejtorive komunale, administratorët e vendbanimeve, këshillat lokal, gratë, të rinjtë, studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtorët shëndetësor dhe të tjerë.

Z. Dobra përshëndeti të pranishmit dhe bëri një prezantim të shkurtër për rëndësinë e takimit, duke theksuar se dëgjimet publike janë pjesë e një procesi demokratik që synon rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore. Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore. Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të bëhet një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit.

Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën kryetarit të Komunës, **z. Ramiz Lladrovci**, për të elaboruar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Në vazhdim, fjalën e mori Kryetari i Komunës, **z. Ramiz Lladrovci**, falënderoi pjesëmarrësit për interesimin dhe pjesëmarrjen e tyre, duke theksuar se çdo sugjerim apo kërkesë e qytetarëve është e rëndësishme për të ndërtuar një buxhet gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit.

Prezentoj Draft-Kornizen Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028, e cila është përgatitur në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2026/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ky dokumente përmbledh kërkesat fillestare për vitin 2026, si dhe projeksionet për vitet 2027–2028. Theksoi se në këtë takim nuk do të diskutohet për raportin e punës së kryetarit, pra nuk do të diskutohet për projektet që kanë përfunduar apo janë në proces. Në këtë takim diskutohen vetëm projektet që janë në prioritetet tuaja për tu implementuar në vitet ardhshme.

Faleminderit për mirëkuptim.

2. Transparenca dhe Pjesëmarrja Publike

Komuna e Drenasit, si një institucion që promovon vlerat demokratike, është e përkushtuar ndaj transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë frymë, dokumentet e prezantuara do të jenë të publikuara për qasje publike gjatë javëve në vijim, duke u mundësuar qytetarëve të shqyrtojnë përmbajtjen dhe të kontribuojnë me komente dhe sugjerime.

Dëgjime të tjera publike do të organizohen gjatë muajve gusht dhe shtator, ku pritet një pjesëmarrje edhe më e gjerë. Qytetarët do të kenë mundësinë të paraqesin propozime konkrete për projektet që i konsiderojnë të rëndësishme për komunitetet e tyre.

3. Ftesa për Propozime

Në vazhdim të takimit, të pranishmit u inkurajuan të paraqesin idetë dhe projektet që përfaqësojnë prioritetet dhe nevojat e komunitetit për vitet në vijim. U theksua se ky takim nuk ka për qëllim diskutimin e projekteve të përfunduara apo atyre që janë në fazën e zbatimit, por është i përqendruar në identifikimin e nevojave të reja dhe në orientimin e investimeve të ardhshme.

Kryetari i Komunës ritheksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, duke theksuar se ky është vetëm fillimi i një procesi të gjatë konsultimesh me qëllim hartimin e një buxheti të drejtë, gjithëpërfshirës dhe efikas.

Qytetarët u ftuan të marrin pjesë në dëgjimet e radhës dhe të kontribuojnë aktivisht me mendimet dhe sugjerimet e tyre. Po ashtu, u njoftuan se çështjet dhe kërkesat e ngritura gjatë këtij takimi do të dokumentohen dhe shqyrtohen me seriozitet nga institucionet përkatëse.

4. Kërkesat e Qytetarëve

Gjatë takimit, qytetarët dhe përfaqësuesit e komuniteteve paraqitën kërkesa dhe propozime konkrete për projekte të cilat, sipas tyre, përfaqësojnë nevojat prioritare të zonave të tyre. Këto kërkesa janë listuar më poshtë sipas vendbanimeve:

Korroticë e Epërme – Z. Xhafer Doberdolani

- Kërkoi diskutim për projektet e papërfunduara.

Kryetari sqaroi se kjo temë do të trajtohet në një takim të veçantë më të përshtatshëm.

Terstenik I dhe II – Z. Bajram Qallapeku

- Asfaltimi i 3 rrugicave në lagjen e Kukaj
- 2 rrugica në lagjen Gjoka
- 1 rrugicë të Dvoran
- 2 në lagjen Bazaj
- 1 në lagjen Demaku

Kryetari kërkoi të sqarohen pronësitë (publike/private) për shqyrtim të mëtejshëm.

Sankoc, Fushticë e Epërme dhe e Poshtme – Z. Kadri Ajazi

- Asfaltimi i rrugicave në çdo lagje
- Trotuar, në Sankoc dhe Fushticë të Epërme nuk ka fare, prej një pjese nga fshati në shkollë, si dhe të Xhamia dhe të varrezat e fshatit, vazhdimin e trotuarit në Fushticë të Poshtme edhe pse një pjesë ka përfunduar,
- Ne si fshat e kemi një ujësjellës rural me pompa por me kapacitet të vogël dhe mundësia është që nga Goleshi i cili është burim me ramjet të lirë të sillen ujësjellsa deri në fshat dhe të kyqet me rrjetin e fshatit në lagjen Shala në fund të fshatit,
- Ndërtimi i fushës sportive në Fushticë të Epërme
- Ndriqimi të vazhdoj në të tri fshatrat,
- Lidhja rrugore Sankoc–Miren dhe Sankoc–Fushticë e Poshtme

Kryetari falënderon z. Ajazi, e kam sqaruar shume herë se bazeni ku është uji është nën hetim që sa vite por ne së bashku duhet ta ruajm bazenin të mos hudhën mbeturinat deri ne përfundim të

procedurave gjyqësore dhe nuk mundemi për momentin të bëjme asgjë, sa i përket fushës së sportit në Fushticë të Epërme do të ndërtohet fusha te shkolla, te Fushtica e Ulët në shkollë është fusha dhe me vendimin tim lejohet shfrytëzimi i atyre pjesëve pas përfundimit të orarit mësimor por pa dëme material dhe me kujdes, kurse në Sankoc kemi me krijuar mundësin për ndërtimin e një fushe sportive. Ndërtimi i trotuareve premtoi që do të shqyrtohet në bazë të prioritetit dhe frekuentimit nga qytetarët.

Gllobar – Z. Murat Elshani

- Të përfundoj kanalizimi të lagjia e Elshanëve dhe te shkolla,
- Prej hyrjes se Gllobarit deri te pishat të i siguroni fidanet dhe sistemin e ujitjes
- Ndriçimi publik është më se i nevojshëm,
- Të vazhdohet asfaltimi i rrugës prej Gllobarit deri në Verboc,
- Rruga rreth varrezave është rrugë publike dhe kemi menduar të shërbej edhe si rrugë edhe si parking gjatë celebrimeve në varreza,
- Rruga Izet Elshani ka mbetur një pjesë e pa shtruar,
- Trotuarin që shkon nga lagjia e Morinëve në Verboc,
- Të lagjia e Kapuqëve një fushë sporti.

Kryetari - falënderon para folësin për bashkpunimin, kurse kërkesat që po i marrim sot i listojmë dhe i shohim se cilat janë me prioritet, ndriçimi ka pas me u kryer po janë procedurat e prokurimit që kur ka ankesa në OSHP vonohen. Në Gllobar sa kemi pasur mundësi i kemi lidhur te pishat rrugët dhe trotuaret dhe tash jemi duke krijuar mundësin për një rrugë prej stadionit përmes rrugës së komosacionit që me i lidhë edhe disa shtëpija e me ndërtuar një urë të vogël për levizje me të lirë, për ujëra të zeza do mundohemi të gjejme një zgjidhje. Për fushën sportive jam për mirëpo do e shohim në bazë të numrit të fëmijëve dhe prioritetëve të fshatit.

I nderuari Ajaz rrugën për Mirenë nuk mundemi me shtrë se nuk kemi të drejt të dalim jashtë territorit tone dhe ajo pjese qe është ne territorin e Drenasit është e shtruar.

Kizhnarek – Z. Imri Bajraktari

- Muri mbrojtës prej varrezave deri në kryq, të zgjerohet rruga si dhe trotuari,
- Lidhja e rrugës Fehmi Bajraktari me rrugën Rexhep Hykolli
- Nevoja për kanalizim

- Hapja e rrugës deri në kufi me Berish dhe propozimi për krijimin e një parku nacional.

Kryetari nëse kemi ndihmë nga qeveria do ta shqyrtojmë.

Llapushnik – Z. Halit Gashi

- Hapja e një qendre ditore për persona me aftësi të kufizuara
- Subvencionim me barna, shtretër, karroca dhe pajisje ndihmëse
- Fushata sensibilizuese dhe përfshirje në programe të mbështetjes sociale
- Transport falas për këtë kategori

Kryetari sqaroi kufizimet buxhetore dhe juridike, dhe përmendi se disa shërbime janë nën kompetencë të nivelit qendror, kujdestarin ne nuk mundemi me pagu për shkak të buxhetit dhe niveli qendror nuk na lejon të ndajmë buxhet për këtë kategori, regjistri i kësaj kategorie është në QKMF por është intern dhe nuk jepet për palet e treta, është lista për subvencionet për barna, dhe kanë pasur të drejtë që të gjithë personat me problem shëndetësorë të aplikojnë për subvencionim dhe komisioni i ka shqyrtuar dhe aprovuar kërkesat e tyre. Karroca kemi ofruar një vlerë të caktuar dhe prapë do mundohemi të sjellim.

Vasilevë, Poklek i Ri dhe i Vjetër – Z. Zeke Kluna

- Ndriçim dhe asfaltim në Vasilevë, si dhe përmirësimi i ujësjellësit
 - Ndërtimi i një shëtitoreje të ujit i thartë dhe asgjësimi i gropës skeptike në Poklek të Vjetër si dhe shkolla ka nevojë për ndriçim, rrethojën dhe ambullantën.
 - Ndërtimi i rrugës dhe rrethojës për varrezat në Poklek të Ri
-

Lagjia Drenasi II dhe Feronikeli – Z. Jahir Beqiri

- Kërkesë për ndërtimin e një kopshti për fëmijë afër shkollës
-

Nekoc – Z. Habib Gashi

- Kanalizim dhe zgjidhje për ujin e grykave që përmyt pronat bujqësore
- Rruga kryesore e fshatit që lidhë rrugën Xheladin Gashi dhe deri të shkolla është e dëmtuar si dhe të ngjiten mbrojtëset e trotuarit
- Ndërtimi i një fushe sportive të lagjia e Plakiqi

- Rruga Hysni Murseli që lidhet me lagjën Muqaku është e bllokuar të bëhet një zgjidhje.

Kryetari - rruga mundet me u riparuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike , rrugën Hysni Murseli kemi filluar me hapë por ka qenë koha e pademisë dhe ajo kompani ka dështuar, për fushë do t'i shohim mundësit.

Shtuticë dhe Verboc – Z. Islam Syla

- Ndriçim në lagjet Syla dhe Bilalli
- Asfaltimi i rrugicave në lagjën Baliu, dhe të Aziz Selmani e cila është me zhavor,
- Rruga Fadil Selmani dhe të Haki Gashi është me zhavor vetëm të asfaltohet.

Kryetari i udhëzon të bëjnë kërkesën me shkrim dhe do shqyrtohet.





Në përmbyllje, pjesëmarrësit u falënderuan për kontributin dhe angazhimin e treguar gjatë takimit.

5. Mbyllja e dëgjimit


Dëgjimi përfundoj në orën [11:40], ky procesverbal reflekton takimin e parë konsultativ publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, me pjesëmarrje aktive nga qytetarët, përfaqësuesit institucionalë dhe komuniteti në përgjithësi. Të gjitha komentet, propozimet dhe kërkesat e paraqitura gjatë këtij takimi do të merren në konsideratë nga Grupi Punues dhe institucionet përkatëse, me qëllim hartimin e një dokumenti buxhetor gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave reale të qytetarëve.

Për çdo koment shtesë apo kontribut të mëvonshëm, qytetarët mund të drejtohen në adresat zyrtare të Komunës së Drenasit.

Dokumentet e bashkëngjitura:

- Ftesa për pjesëmarrje;
- Lista e pjesëmarrësve;

Përpiloi: **Fluida Nika**



Zyrtare e Lartë për Financa





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2026-2028
Administratorë, këshilla lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të
kufizuara, punëtor shëndetësor etj

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M/F	Nënshkrimi
1	XHAFER	DOBËRDOLAKI	M	Xhafer
2	Imri Shajkollari	Shajkollari	M	Shajkollari
3	KADRI	HAZI	M	Kadri
4	HETEM	HAZI	M	Hetem
5	HABIB	GASHI	M	Habib
6	GRANI KRANJOSI		M	Grani
7	Egona	Terdenci	F	Egona
8	Rustem	Bullaku	M	Rustem
9	LSIAH	SJIA	M	LSIAH
10	ZERË KLARI	PAKLEK	M	Zerë
11	KASTRIOT HOXHA	DARIANEK KRAIKOV	M	Kastriot
12	BIJAR DERVISHI	GJATANI EVO	M	Bijar
13	Anberije Gllareva	Drenas	F	Anberije
14	Luljeta Hekihu	Drenas	F	Luljeta
15	Kimete Dorri	Drenas	F	Kimete
16	Bislime Dvorani	Drenas	F	Bislime
17	EKREM SHARCA	DRENAS	M	EKREM
18	Liridona Fejza-Ajze	Fejza-Ajze	F	Liridona
19	LIRIDONE	MULAKU	F	Liridone
20	HABIB TAHIRI	DRENASI	M	Habib
21	BAJKAN GJATANI	TGPSTENI	M	Bajkan
22	Shkëlqez	SHKËLQEZ	M	Shkëlqez
23	MURAT ELSHANI	ELSHANI	M	Murat
24	Enver Hoxha	SHARCA	M	Enver
25	AFRIM GLLAREVA	GLLAREVA	M	Afrim
26	Djela Basha	Haputunika	F	Djela

27	Hulum Janova	Sankuq	M	
28	Ali Janova	Ljaniq, Sankuq	M	
29	Faiz	Gash	M	
30	Halit	Gash	M	
31	Laureta	Thaqi	F	
32	Krion Krasniqi	Thaqi	M	
33	Muhamet	Gash	M	
34	Agnes Kastrati Bredli	Alibon	F	
35	Lymije	Gash - Krasni	F	
36	PETRI	GASHI	M	
37	Hexumedin	Grada	M	
38	Albulena Saliuku	Saliuku	F	
39	FLUIDA	NIKA	F	
40	Bekim	Dobra	M	
41	Arban	Shala	M	
42	KUSHEIM	BASRAKTARI	M	
43	ENOKIT	GLAKOVA	M	
44	Ramiz Hadrova		M	
45	Elmi Yhala	Hegroc	M	
46				
47				
48				
49				
50				

P.s: Ne këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografitë e takimit të përdoren për komunikim zyrtar.